STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 3 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON SE SISTEMI I KANALEVE DO TË HAPET PLOTËSISHT NESËR NË MËNGJES PËRPARA PARASHIKIMIT

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se Sistemi i Kanaleve të Shtetit të Nju Jorkut do të hapet plotësisht për qarkullim nesër më 4 nëntor në orën 7:00 të mëngjesit, një ditë përpara parashikimit me rihapjen e Kanalit Erie nga Lock E-8 (Scotia) deri Lock E-17 (Little Falls).

Në fillim të kësaj jave, guvernatori njoftoi se Sistemi i Kanaleve do të hapet të hënën më 5 nëntor.

Nivelet e ujit të sistem janë ulur për të pakësuar rrezikun e përmbytjeve si rezultat i uraganit Sandy. Goditja e stuhisë në kanal ishte minimale dhe nuk pati dëmtime të portave, digave apo strukturave të tjera të kanaleve.

Rikthimi i nivelit të ujërave në të gjithë sistemin e kanaleve do të lejojë kalimin e anijeve zbavitëse dhe ato tregtare që ndodhen aktualisht në sistemin prej 524-milje për të vazhduar dhe përfunduar udhëtimin e tyre përpara se të mbyllet sistemi për muajt e dimrit më 15 nëntor.

Përveç lundrimit, Sistemi i Kanaleve të Shtetit të Nju Jorkut është i rëndësishëm edhe si burim uji të pijshëm si dhe burim për përdorim prodhimi energjie dhe në bujqësi.

Sistemi i Kanaleve të Shtetit të Nju Jorkut është një rrjet ujor i lundrueshëm prej 524-milje që shtrihet deri në pjesën veriore të Nju Jorkut. Rrjeti ujor lidh lumin Hudson me liqenet Champlain, Ontario, Cayuga, Seneca, dhe Erie nëpërmjet lumit të Niagarës.

Sistemi i Kanaleve përfshin katër kanale: Erie, Champlain, Oswego dhe Cayuga-Seneca; rrjetet e kanalizuara natyrore, plus pesë liqene: Oneida, Onondaga, Cross, Cayuga dhe Seneca; pjesë të shkurtra të kanaleve në Ithaca dhe Watkins Glen; rezervuaret ushqyes; kanalet dhe lumenjtë të palundrueshëm me anije nga Kanali; si dhe terminalet e Kanalit në liqenin Champlain. Sistemi i Kanalit përshkon 25 komuna dhe rreth 200 fshatra, katund dhe qyteza.

Marinarët e kanalit mund të abonohen me email në TRANSalerts për njoftimet e reja për gjendjen e Kanalit duke vizituar http://www.canals.ny.gov/tas/index.shtml.

Njoftimet e fundit dhe informacionet i gjeni duke telefonuar në 1-800-4CANAL4 ose duke vizituar www.canals.ny.gov.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian